

**REMZI NESIMI****PROCESI I NJËSIMIT TË SHQIPES LETRARE  
NË MAQEDONI**

*Njësia e gjuhës është njësia e kombit  
Aleksandër Xhuvani*

Duke u nisur nga kjo e vërtetë, si dhe nga fakti se gjuha letrare është thesari më i madh i një populli e njëkohësisht edhe shoqëruesi më besnik i kulturës në përgjithësi, pothuaj të gjithë ideologët dhe përfaqësuesit më kryesorë të Rilindjes sonë kombëtare çështjes së gjuhës i patën kushtuar kujdesin më të math. Ata në kushtet e asaj kohe përcaktuan edhe drejtshkrimin e atëhershëm, e pastruan gjuhën nga barbarizmat, e pasuruan fondin leksikor me fjalë nga brumi i shqipes dhe në këtë mënyrë kryen një mision të lartë patriotik. Rilindësit e shquar, vëllezërit Frashëri, Vaso Pasha, De Rada e të tjerë gjuhën shqipe nuk e përdorën vetëm si mjet kulture dhe edukate, por edhe si mjet për zgjimin e kombit. Prandaj s'është gjë e rastit që paralelisht me botimin e veprave të ndryshme letrare filluan të botohen edhe vepra shkencore gjuhësore siç është gramatika e Kristoforidhit, ajo e Sami Frashërit, me të cilën fillon edhe procesi i normalizimit si i drejtshkrimit ashtu edhe i gjuhës sonë të shkruar.

Ideja e rilindësve, që me anë të një drejtshkrimi të njësuar të shkohet edhe drejt një gjuhe të njësishtme letrare kombëtare, vazhdoi edhe në prak të çlirimit nga robëria otomane, edhe pas çlirimit. Me zgjidhjen e çështjes së alfabetit të shqipes më 1908 në Manastir, pothuaj u krijuan kushte më të volitshme për stabilizimin e shqipes letrare, por megjithatë u desh një kohë mjaft e gjatë gjersa t'i arrihej qëllimit përfundimtar, do të thotë u desh një punë e shumëanshme dhe e vazhdueshme e linguistëve shqiptarë që nga vitet e pasçlirimit e gjer në vitet e fundit të dhjetëvjetshit të shtatë kur, me botimin e «Rregullave të drejtshkrimit të gjuhës shqipe» u kurorejuan përpjekjet afër njëqindvjeçare, jo vetëm në planin e njësimit të drejtshkrimit të shqipes, por edhe në unifikimin e normës së gjuhës sonë kombëtare.

Fakti që vetëm gjatë këtij shekulli u hartuan e u përpunuan afër 10 projekte dhe rregulla mbi ortografinë e gjuhës shqipe, flet se ç'levizje e përpjekje të mëdha janë bërë për stabilizimin e drejtshkrimit, për afrimin e dy kryedialekteve dhe për kristalizimin e

normës letrare në përgjithësi. Prandaj aprovimi i «Rregullave të drejtshkrimit» në këtë Kongres, si dhe vetë Kongresi, paraqet një ngjarje shumë të rëndësishme historike të kulturës shqiptare, sepse krahas kurorëzimit të sukseseve të panumërta në zhvillimin e gjuhës shqipe, e cila sot ka arritur në atë shkallë zhvillimi që të mund të shprehë çdo konception shkencor e letrar e të mos ngelë prapa edhe gjuhëve më të zhvilluara, sot realizohen idealet e përfaqësuesve dhe të patriotëve të Rilindjes, të intelektualëve e të shkencëtarëve që punuan pareshtur në shërbim të popullit për të përhapur gjuhën dhe dritën e kulturës kombëtare dhe idealet e gjithë kombit.

Sikurse në qendra të ndryshme, në Stamboll, në Bukuresht etj., ashtu edhe në Maqedoni janë bërë mjaft përpjekje për zhvillimin e shqipes letrare. Sidomos një vend të rëndësishëm në këtë proces, përkatësisht në krijimin e alfabetit definitiv të shqipes, zë edhe Manastiri, i cili prej kohësh ka qenë qendër e njohur kulture në Gadi-shullin ballkanik. Një vit pas mbajtjes së Kongresit të Manastirit, që është shënuar si ngjarje shumë e rëndësishme historike në jetën kulture shqiptare, shoqëria botuese letrare e po këtij qyteti botoi edhe Abetaren e njërës nga pedagoget e para të arësimit kombëtar, Parashqevi Qirijazit. Dhe jo vetëm kaq. Në këtë vend dhe në qendrat e tjera vepruan edhe mjaft shoqëri kulture; u botuan gazeta, siç janë «Kosova» (1908), «Shkupi», që dilnin në Shkup. Por për shkak të rrethanave të njohura historike, për më se 30 vjet, sikurse në Kosovë ashtu edhe në Maqedoni, u shua çdo gjurmë e kulturës kombëtare. Vetëm pas Luftës së dytë botërore, krahas me hapjen e shkollave në gjuhën shqipe prej fillores e gjer në shkollat e larta, filloi tek ne edhe veprimtaria e gjerë botuese në gjuhën shqipe.

Që në vitet e para pas çlirimit të ne u krijuan dy qendra kulture: Prishtina në Kosovë dhe Shkupi në Maqedoni. Në të dyja këto qendra u zhvillua edhe një veprimtari botuese. Përveç shumë teksteve shkollore, në Shkup filloi të dalë «Flaka e vëllazërimit», në Prishtinë «Rilindja» e më vonë edhe revista e botime të tjera. Ndonëse në këto dy qendra gjer më 1968 u përdor gegërishtja letrare, në pikëpamje ortografike kjo gegërishte nuk ka qenë krejtësisht e njëjtë. Kjo është e kuptueshme kur të marrim parasysh se edhe në Republikën Popullore të Shqipërisë për disa vjet, edhe pas çlirimit u përdor një drejtshkrim jo i njësuar, sepse njësimi i ortografisë varet edhe nga njësimi i normës së gjuhës së shkruar, e kjo nga vetë kushtet historike të zhvillimit kultural të një populli.

Duke u nisur nga ky fakt, mendojmë se ka qenë gjë iluzore që, qoftë në Kosovë, qoftë në Maqedoni, në dy dekadat e para pas çlirimit, në kushtet e një prapambetjeje të ndjeshme intelektuale e shpirtërore, të mendohej për një unifikim të plotë të gjuhës letrare kombëtare. Për këtë kanë qenë të vetëdijsëm si punonjësit shkencorë ashtu edhe arësimitarët, punonjësit e kulturës dhe të gjithë ata që kanë të bëjnë me gjuhën e shkruar. Prandaj ecuria e njësimimit të drejtshkrimit dhe e unifikimit të plotë të gjuhës sonë, ka qenë graduale e sistematike.

Ndonëse në Maqedoni, përkatësisht në kryeqendrën e saj pas çlirimit nuk është mbajtur ndonjë sesion shkencor mbi gjuhën, çësh-

tjes së gjuhës letrare gjithnjë i është kushtuar një vëmendje e veçantë. Parimi themelor i intelektualëve tanë gjithnjë ka qenë që të ndiqet ajo ortografi dhe bile edhe ajo gjuhë që përdoret në vendin ëmë.

Prandaj në Maqedoni si në shkolla ashtu edhe në teatër, në shtyp e në radio edhe para vendosjes së një gjuhe letrare të njësuar është përdorur gjuha dhe ortografia e variantit letrar verior të mesëm. Përveç faktit që pjesa më e madhe e të folmeve shqipe të Maqedonisë bëjnë pjesë në zonën e Gegërisë së Mesme e një pjesë në dialektin jugor, procesin e zhvillimit të shqipes në baza të gjuhës së Shqipërisë së Mesme e ndihmuan mjaft edhe një numër i madh i arësimtarëve ish-normalistë të Elbasanit, si dhe të vendeve të tjera jugore të Shqipërisë, që shërbyen vite me radhë në qendra të ndryshme të Maqedonisë: në Shkup, në Tetovë, Gostivar, Dibër, Strugë etj. Për shërbimet e tyre të mëdha të gjithë këta punonjës të zellshëm meritojnë respektin dhe mirënjohjen tonë të thellë.

E gjithë kjo flet se në Maqedoni, që kur filloi të përdoret gjuha letrare, kemi pasur një ecuri paralele si me drejtshkrimin, ashtu edhe me gjuhën letrare të përdorur në vendin ëmë. Në vitet e para u përdor drejtshkrimi që qe përdorur në tekstet gramatikore të profesor Xhuvanit, pastaj ortografia që u botua më 1948, drejtshkrimi i vitit 1952 dhe më në fund ortografia e gjuhës shqipe e vitit 1956, e cila është mjaft e lehtësuar nga shumë elemente komplikuese si përdorimi i theksave, i apostrofit e të tjera. Kjo flet se punonjësit e kulturës dhe arësimtarët në këtë republikë asnjëherë nuk i lejuan vetes që të mbyllen në një gegërishte të prerë me veçori të të folmeve krahinore, siç ishte rasti në disa qendra të tjera.

Është e ditur se gegërishtja letrare e Shqipërisë së Mesme gjithnjë ka shkuar drejt afrimit të drejtshkrimit të toskërishtes, prandaj në shtypin dhe në veprat e botuara në Shkup janë preferuar format e përbashkëta. Bile edhe në ato raste kur ortografia e vitit 1956 për gegërishten lejonte format pa ë te fjalët si: *shoqni, shoqnor, kallzues*, etj., në shtypin tonë këto janë përdorur me ë e të mos flasim për derivatet e tjera, në të cilat ë-ja, qoftë në trup të fjalës, qoftë në pozitë fundore, është përdorur rregullisht, sikurse në drejtshkrimin e sotëm: *miqësi, shpejtësi, drejtësi*; ose të *rijtë, barijtë*, apo te emrat oksitonë në rasat e zhdrejta në trajtën e shquar: *shtëpisë, shtëpinë* e të tjera.

Kjo zanore, e cila në punime e në studime gjuhësore është quajtur me emra të ndryshëm si: *e pa zë*, gjysmë zanore, zanore e turbullt, zanore e paqendrueshme e të tjera, ka qenë objekt diskutimesh dhe shkak divergjencash në ortografinë e ndryshme të gjuhës shqipe. Në pikëpamje të përdorimit të këtij vokali, gjer më 1963 ka pasur mjaft ndryshime edhe në botimet e Shkupit me ato të Prishtinës. Kështu, gjersa në botimet e Prishtinës ndiqej parimi fonetik i të folmeve të Kosovës dhe të atyreve veriore, në të cilat ë-ja e patheksuar në pozita të ndryshme është reduktuar krejtësisht, në botimet e Shkupit është ndjekur parimi fonetik i të folmeve jugore. Mendojmë se pikërisht ky tingull bën që të folmet jugore, përkatësisht gjuha e sotme e njësuar të cilësohet si gjuhë melodike dhe kumbuese.

Prandaj punonjësit e arësimit dhe të kulturës në Maqedoni, kurdoherë kanë qenë idhëtarë për një drejtshkrim të njësuar si edhe për një shqipe të njësishme letrare kombëtare. Për këtë edhe shtypi ka mbajtur gjithnjë qëndrim korrekt. Mendojmë se kjo që një ndër shumë indikatorët e tjerë që në mënyrë indirekte ndikoi të konvokohet mbledhja për ortografinë e gjuhës shqipe në Prishtinë, më 1963. Në këtë mbledhje, si edhe në Konsultën gjuhësore të Prishtinës që u mbajt më 1968, diskutuan edhe shumë arësimitarë, punëtorë të kulturës e dashamirë të fjalës së shkruar nga Maqedonia. Të gjithë vunë në dukje faktin se shqipja letrare, kudo që të përdoret, duhet të ketë një drejtshkrim të njësuar. Po kështu ata insistuan se tanimë janë pjekur kushtet për të bërë edhe hapin e fundit — ta unifikojmë jo vetëm drejtshkrimin, por edhe gjuhën letrare. Për këtë flet edhe fakti se pas botimit të Projektit të Rregullave të drejtshkrimit të shqipes, disa muaj para se të mbahej Konsulta gjuhësore në Prishtinë, «Flaka e vëllazërimit» kishte filluar të dalë në gjuhën e sotme letrare dhe me këtë u realizua edhe një e vërtetë shkencore, u realizuan dëshirat qindravjeçare, sepse vetë fjala «gjuhë e njësuar letrare» kumbon ëmbël për çdo shqipfolës.

Është gjë e natyrshme, që u paraqitën edhe vështirësi serioze në zbatimin dhe në përvetësimin e kësaj gjuhe e sidomos në komunikimin gojor. Bile në muajt e parë vëreheshin lëshime edhe në shtyp e sidomos në përdorimin e imperfektit, të kohëve të përbëra, të cilat përshtateshin sipas gegërishtes letrare si: *kam punua* nga *kam punue* etj. Po kështu përshtatje joadequate ka pasur edhe në përdorimin e infinitivit të tipit *për të* + *particip*, me të cilin edhe kur lejon, edhe kur nuk lejon natyra e gjuhës së sotme zëvendësohej infinitivi i gegërishtes i tipit *me punue*, *me shkue* e të tjera të foljet që tregojnë ndonjë dëshirë apo të thënë si për shembull: *dua për të shkuar* nga gegërishtja *due me shkue* në vend të *dua të shkoj* e të tjera.

Për përhapjen e normës së njësuar letrare, përveç shkollës, mjeteve të informimit të përditshëm, botimeve e të tjera, si në Kosovë ashtu edhe në qendra të ndryshme në Maqedoni si në Shkup, në Gostivar e të tjera, janë organizuar seminare për arësimitarët e profileve të ndryshme dhe janë trajtuar çështje pikërisht të gjuhës shqipe të njësuar. Sidomos procesin e përvetësimit të normës letrare të njësuar e ka ndihmuar dhe e ka shpejtuar shumë ribotimi i veprave letrare e shkencore të Republikës Popullore të Shqipërisë në Prishtinë dhe në Shkup.